



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - DEGA E GJYKATËS RAHOVEC

Numri i lëndës: 2022:114742

Datë: 10.12.2024

Numri i dokumentit: 06574327

C.nr.371/2022

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC, Departamenti i Përgjithshëm, Divizioni Civil, gjyqtari Avni Berisha, me bashkëpunëtoren profesionale Shpresa Haxhijaha Rahmani, në çështjen juridike kontestimore të paditësve F.F nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit të cilin e përfaqëson avokat Q.K nga Prizreni, A.P, O.P dhe O1.P që të tre nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, të cilët i përfaqëson avokat S.M nga Prizreni, sipas autorizimit në shkresat e lëndës, kundër të kundër të paditurës B, me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 4,000.00 euro, jashtë seancës, me datë 10.12.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

KONSTATOHET E TËRHEQUR padia e paditësve F.F nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit, A.P, O.P dhe O1.P që të tre nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, në lidhje me këtë çështje juridike.

A r s y e t i m

Paditësit F.F nga fshati Celinë, Komuna e Rahovecit të cilin e përfaqëson avokat Q.K nga Prizreni, A.P, O.P dhe O1.P që të tre nga fshati Bellacërkë, Komuna e Rahovecit, pranë kësaj gjykate ka parashtruar padi kundër të paditurës B, me seli në Prishtinë, për kompensim dëmi, vlera e kontestit 4,000.00 euro.

Përfaqësuesi i autorizuar i paditësve me parashtrësën e datës 23.12.2022, e ka tërhequr padinë ndaj të paditurës së lartcekur, me arsyetim se në lidhje në këtë çështje kontestimore të dy avokatët si përfaqësues të palëve paditëse kanë arritur marrëveshjen jashtëgjyqësore me të paditurënme datë 16.12.2022.

Gjykata pas shqyrtimit të shkresave të lëndës, duke pas parasysh edhe tërheqjen e padisë ka ardhur në përfundim se padia e paditësve të konstatohet e tërhequr në kuptim të nenit 261 parag. 1 të LPK-së, i cili e përcakton se *“Paditësi mund ta tërheqë padinë pa pëlqimin e të paditurit deri në momentin në të cilin i padituri e paraqet në gjykatë përgjigjen në padi...”*.

Nga arsyet e cekura më lartë gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktvendimi në kuptim të nenit 261 lidhur me nenin 387 parag. 1 pika c) të LPK –së.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË – DEGA NË RAHOVEC,
Departamenti i Përgjithshëm / Divizioni Civil,
C.nr.371/2022, me datë 10.12.2024.

Gj y q t a ri
Avni Berisha

UDHËZIM JURIDIK: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa, konform nenit 261.4 të LPK-së.